



Dalës-lizazna

Nr. XIV-194  
Br.

Data 16.12.2019  
Datum

OBILIQ-OBILIC



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo- Republic of Kosova**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Kuvendi Komunal Obiliq-Skupstina Obilic-Municipality Assembly Obiliq**  
**Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit**

Data:	16.12.2019
Nga:	Ilire Kelmendi Shema, Drejtoreshë në DKRS-ë
Përmes:	z. Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës
Për:	Kuvendin Komunal të Obiliqit
Lënda:	Kërkesë



I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Duke u bazuar në nenin 11 dhe 12 pika 2. Shkronja d të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 4 pika 1.1.2 dhe 5.2 të Ligjit nr.04/L-164 për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe Ansambleve të Tjera dhe nenin 5 pragrafit 2. Statutit të Komunës të datës 25.04.2016 me Nr.34, nenit 37 dhe 85.

DKRS-ja, propozon inicimin në Kuvendin Komunal, për themelimin e Ansamblit Komunal të Qytetit të Obiliqit.

**Arsytimin gjeni të bashkangjitur.**

Me respekt !

**Arsytim:**

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, me 1 tetor 2019 ka pranuar kërkesën të parashtruar nga shoqria kulturore (Ansamblit Artistik i Këngëve dhe Vallëve "Xhavit Haziri" të Obiliqit, me statut aktual OJQ, i cili është i organizuar me një staf udhëheqës dhe menaxherial dhe gëzon një anëtarësi të gjërë, prej 108 antarësh, në kuadër të stafit udhëheqës të ansamblit bëjnë pjesë: Me një përbërje të kryesisë prej pesë (5) antarësh,

Ansamblit i Qytetit të Obiliqit i Këngëve dhe Valleve, operon që nga vitet e nëntëdhjeta me aktivitete kulturore, duke bërë një traditë në ruajtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore në trevën tonë. Dhe si i tillë ka arritur mjaft suksese si në Kosovë po edhe jashtë saj.

Ansamblit aktivitetin e zhvillon me moshat nënt (9) vjeqare deri pesdhjet (50) vjeqare, njëherit zhvillon aktivitet (5) herë gjatë një jave kalendarike.

Pas shqyrtimit të kërkesës, DKRS-ja, propozon iniciimin e kërkesës në Kuvendin Komunal, për themelimin e Ansamblit Komunal të Qytetit të Obiliqit. Duke përcaktuar dhe definuar statusin juridik si dhe mënyren e financimit të Ansamblit Artistik të Këngëve dhe Valleve të Obiliqit.

AAKV, ka si qëllim realizimin e aktiviteteve kulturore, të cilat, përmes këngëve, valleve dhe koreografive të ndryshme, ruajnë dhe kultivojnë traditën, doket dhe zakonet, para së gjithash të rajonit të Obiliqit, por edhe të trevave tjera shqiptare.

Që përmes këngëve dhe valleve të kultivojë epikën dhe lirikën e popullit tone ndër shekuj.

Që t'i sigurojë, t'i ruajë dhe t'i prezantojë veshjet popullore me elemente etnografike të rajonit të Obiliqit, por edhe të trevave të tjera shqiptare.

Përmes kësaj kërkesë, kërkohet ç'ë të krijohet Ansamblit Artistik Komunal i Obiliqit nga Kuvendin Komunal, në fazat e më tejme parashihet konsuldimi i statutit dhe organev tjera.

Me respekt !